

<p style="text-align: center;"><b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHITJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSI NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b></p>
---	---	--

**ASC-09-0094**

Në lëndën SCEL-09-0018  
NSH " [REDACTED] " Viti

- [REDACTED], fshati Gërmovë, Viti, Ankuesi nr.3
- [REDACTED], fshati Vërban, Viti, Ankuesi nr.4
- [REDACTED], fshati Pozharan, Viti, Ankuesi nr.6
- [REDACTED], fshati Pozharan, Viti, Ankuesi nr.8
- [REDACTED], fshati Pozharan, Viti, Ankuesi nr.9
- [REDACTED], fshati Sllatinë e Epërme, Viti, Ankuesi nr.10
- [REDACTED], fshati Tërstenik, Viti, Ankuesi nr.11
- [REDACTED], fshati Smirë, Viti, Ankuesi nr.12
- [REDACTED], fshati Pozharan, Viti, Ankuesi nr.13
- [REDACTED], fshati Tërstenik, Viti, Ankuesi nr.14
- [REDACTED], fshati Gërmovë, Viti, Ankuesi nr.15
- [REDACTED], fshati Pozharan, Viti, Ankuesi nr.18

*Ankuesit*

kundër

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Rruga Ilir Konushevci, nr.8, Prishtinë

*I Padituri/Ankuesi*

Kolegji i Ankesave pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank

Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 8 mars 2010 lëshon këtë

## **AKTVENDIM**

- 1. Ankesat e Ankuesve/Apeluesve hidhen poshtë si të papranueshme.**
- 2. Ankesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit refuzohet si e pabazuar.**
- 3. Vërtetohet aktvendimi i Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme në lëndën SCEL-09-0018 i datës 15 tetor 2009.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 15 tetor 2009 Trupi Gjykses i DHPGJS-së lëshoi një aktvendim në lëndën SCEL-09-0018, me të cilin e shpalli të pavlefshëm listën e punëtorëve të NSH "Agromorava", me të drejta legjitime për pjesëmarrje në të ardhura nga privatizimi. Trupi Gjykses më tutje udhëzoi të Paditurin që të përgatisë një listë të re sipas ligjit dhe që Komisioni Shqyrtues, të cilit i është besuar përgatitja e kësaj liste, duhet të përbëhet dhe të veprojë në përputhje të plotë me ligjin.

### *Ankesat e Ankuesve*

Ankuesit në kohë kanë ushtruar ankesat e tyre kundër aktvendimit të përmendur.

Ankuesit/Apeluesit e kundërshtojnë aktvendimin në tërësi pasi që nuk kanë qenë të përfshirë në listën e punëtorëve. Ata kërkojnë nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së që të "rishikojë" listën e përpiluar nga i Padituri.

Më 30 dhjetor 2009 Kolegji i Ankesave i urdhëroi Ankuesit/Apeluesit që të ofrojnë një kopje të aktvendimit kundër të cilit është ngritur ankesa dhe një deklaratë të

datës kur u është dërguar aktvendimi i Trupit Gjykses. Ankuesit/Apeluesit [REDACTED] dhe [REDACTED] nuk u janë përgjigjur urdhrit. Ankuesit/Apeluesit [REDACTED] dhe [REDACTED] në përgjigjen e tyre ndaj urdhrit nuk kanë ofruar aktvendimin e Trupit Gjykses dhe nuk kanë deklaruar datën kur u është dërguar atyre aktvendimi, siç është kërkuar. Ankuesit/Apeluesit [REDACTED] dhe [REDACTED] ofruan aktvendimin e Trupit Gjykses, por nuk treguan për datën se kur u është dërguar atyre aktvendimi i Trupit Gjykses.

#### *Ankesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit*

Më 26 nëntor 2009 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka paraqitur një parashtresë në lidhje me aktvendimin e Trupit Gjykses për SCEL-09-0018.

Më 4 janar 2010 Kolegji i Ankesave urdhëroi AKP-në që të sqarojë nëse parashtresa e datës 26 nëntor 2009 duhet të konsiderohet si ankesë. Në përgjigjen ndaj urdhrit më 27 janar 2010 AKP-ja pohoi se parashtresa duhet të konsiderohet si ankesë.

AKP-ja paraqiti se "organi administrativ i shkallës së parë", i cili në atë kohë ishte organi i vetëm administrativ, veprroi në pajtim me nenin 53.2 të Ligjit mbi Procedurën Administrative (të shpallur me RREG UNMIK 2006/33) dhe nenin 67.4 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, pasi që kishte kontaktuar të gjithë punëtorët, të cilët nuk kishin ofruar dëshmi ose informacione të mjaftueshme. Gjithashtu, ajo pohon se Komisioni Shqyrtues i listave të punëtorëve pas themelimit të tij më 1 tetor 2009 nuk kishte shqyrtuar ankesat pasi që e kishte konsideruar se është çështje e gjykatës që të vendosë për këto ankesa. Lidhur me këtë Komisioni Shqyrtues duke vepruar si organ administrativ i shkallës së dytë do të vepronte sipas aktvendimit përfundimtar të gjykatës duke i bërë korrigjimet dhe ndryshimet e mundshme në listën e punëtorëve.

AKP-ja kërkon nga Kolegji i Ankesave që të ndryshojë pikën një të dispozitivit të aktvendimit të Trupit Gjykses. AKP-ja paraqet se nëse Komisioni Shqyrtues e

miraton listën pa ndonjë ndryshim nga lista e mëparshme, nuk do të ketë nevojë që të publikohet një listë e re, dhe lista e miratuar mund të pranohej si listë që plotëson kërkesat ligjore. Në vend se të publikohet një listë e re Agjencia do të mund të lëshonte një njoftim për Dhomën e Posaçme.

### **Arsyet ligjore:**

#### *Ankesat e Ankuesve*

Kolegji i Ankesave ka shqyrtuar ankesat e Ankuesve/Apeluesve sa i përket nenit 61.4 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 dhe ka ardhur në përfundim se ankesat janë të papranueshme.

Neni 60.2 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 thotë se aktvendimi i Trupi Gjykses duhet të bashkëngjitet ankesës. Në ankesë duhet të shënohet data kur i është dorëzuar vendimi ankuesit. Me urdhrin e datës 30 dhjetor 2009 Ankuesit/Apeluesit u njoftuan nga Kolegji i Ankesave se nëse ata nuk i plotësojnë ankesat e tyre apo nuk ofrojnë dokumentet e kërkuara, Kolegji i Ankesave do të refuzojë ankesat mbi baza të papranueshmërisë.

Ankuesit/Apeluesit nuk përmbushën këtë urdher. Ankuesit/Apeluesit nr.4, 10, 11, 12, 13 dhe 14 nuk dorëzuan asnjë nga dokumentet e kërkuara. Ankuesit/Apeluesit nr.15 dhe 18 nuk dorëzuan aktvendimin e kërkuar dhe deklaratën e datës kur u është dërguar atyre aktvendimi, Ankuesit/Apeluesit nr. 3, 6, 8 dhe 9 pjesërisht përmbushën urdhrin. Ata ofruan vetëm aktvendimet e Trupit Gjykses. Kështu, ankesat e Ankuesve/Apeluesve duhej të refuzoheshin si të papranueshme.

Ankuesit/Apeluesit janë persona fizikë, të cilët mund të mos kenë njohuritë e kërkuara për të përmbushur urdhrat e gjykatës. Në rastin në fjalë nuk kërkohej gjithsesi që t'u rezervohej atyre një mundësi e dytë për të përmbushur urdhrin e gjykatës, për arsyet në vijim: Duke marrë parasysh konkluzionin e aktvendimit të Trupit Gjykses, i cili është vërtetuar, siç shpjegohet më vonë në këtë aktvendim,

Ankuesit/Apeluesit nuk kanë interes ligjor për t'u ankuar. Aktvendimi i Trupit Gjykses e shfuqizon tërësisht listën e punëtorëve me të drejta legjitime të NSH "██████████" dhe AKP-ja është e detyruar që të përgatisë një listë të re të punëtorëve me të drejta legjitime sipas ligjit. Pas shqyrtimit të brendshëm të listës së re nga AKP-ja, lista përfundimtare së bashku me një njoftim për të drejtën e ankesës publikohet në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetata kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetata kryesore në gjuhën serbe.

Të gjitha ankesat, të cilat veçse ishin parashtruar në Dhomën e Posaçme pas publikimit të listës tani të shfuqizuar të punëtorëve me të drejta legjitime të NSH "██████████" Viti, do të merren parasysh si ankesa kundër listës së sapo publikuar të punëtorëve me të drejta legjitime të NSH-së së lartpërmendur po qe se shqetësimet e tyre nuk do të adresohen në listën e re. Të gjithë punëtorët duke përfshirë ata, që më parë nuk kanë ushtruar në kohë ankesat e tyre në Dhomën e Posaçme apo ankesat që nuk plotësojnë kërkesat tjera ligjore të përcaktuara në nenin 67.6 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, do të kenë mundësinë të ushtrojnë ankesë të re pas publikimit të listës së re.

#### *Ankesa e të Paditurit*

Ankesa e të Paditurit është e pranueshme por e pabazuar. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 Kolegji i Ankesave ka vendosur që ta refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Neni 67.5 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 përcakton se lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime, e vendosur nga Bordi i Drejtorëve në pajtim me nenin 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13 dhe e krijuar sipas nenit 67.2 deri 67.5 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 publikohet në pajtim me nenin 10.3 të RREG UNMIK-ut 2003/13. Si e tillë kërkesat për një listë të vlefshme të punëtorëve janë:

- Vendimi i Bordit të Drejtorëve në pajtim me nenin 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13, dhe
- Publikimi në pajtim me nenin 10.3 të RREG UNMIK-ut 2003/13, që do të thotë publikimi në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetën kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetën kryesore në gjuhën serbe.

Lista është në pajtim me nenin 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13 nëse shqyrtohet dhe rregullohet nga Agjencia.

Pasi që Agjencia Kosovare e Mirëbesimit si "Agjenci" e cila, në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë duhet të jetë ajo që merret me privatizimin e NSH-ve dhe shpërndarjen e 20 përqindëshit tek punëtorët me të drejta legjitime, nuk vepron më në këtë fushë të përgjegjësisë të saja, dhe pasi që i Padituri/Apeluesi i ka marrë këto përgjegjësi në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 03/L-06) Dhoma e Posaçme i pranon aktivitetet e AKP-së si një realitet i dukshëm për t'ua mundësuar punëtorëve të përfshirë në procesin e privatizimit të kenë qasje efektive në gjykatë në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo nuk do të thotë se Dhoma e Posaçme e pranon Ligjin për AKP-në si ligj në fuqi në Kosovë, por për të siguruar një proces të sigurt dhe të drejtë të privatizimit ky Ligj për AKP-në duhet të trajtohet si rregullore e brendshme e vlefshme dhe detyruese e organizatës në kuadër të procesit të privatizimit. AKP-ja, faktikisht duke vepruar si pasardhëse e AKM-së në fushën e privatizimit, kështu duhet – të paktën në këtë kontekst – të respektojë rregullat e specifikuar në Ligjin për AKP-në.

Neni 24.1 i Ligjit për AKP-në, në pajtim me të cilin është themeluar AKP-ja si entitet faktik, përcakton se, Agjencia do të themelojë Komisionet Shqyrtuese. Këto Komisione Shqyrtuese do të kenë tre anëtarë, njëri ndër të cilët është anëtar ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar siç përcaktohet me nenin 24.2 të Ligjit për AKP-në. Ky person e kryeson Komisionin Shqyrtues. Çdo person i dëmtuar nga një veprim ose lëshim i Agjencisë ka të drejtë të paraqesë

një kërkesë me shkrim për shqyrtimin e veprimit ose vendimit nga një Komision Shqyrtues. Neni 24.8 i Ligjit për AKP-në përcakton se secili vendim përfundimtar i Agjencisë, duke përfshirë Komisionet e saj Shqyrtuese, mund të kundërshtohet para Dhomës së Posaçme. Kjo tregon se AKP-ja ka organizuar rishikimin e saj të brendshëm në kuptimin që Komisioni Shqyrtues siç përshkruhet në ligj është përgjegjës për shqyrtimin sipas nenit 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13 dhe se lista është përfundimtare atëherë kur të jetë shqyrtuar nga Komisioni Shqyrtues.

Në rastin në fjalë vet i Padituri/Apeluesi thekson se Komisioni Shqyrtues nuk kishte ekzistuar në kohën e shqyrtimit të parë të listës dhe se lista ishte shqyrtuar nga organi administrativ i shkallës së parë. Kjo nuk është në pajtim me ligjin që themelon AKP-në. Prandaj lista nuk mund të konsiderohet si e shqyrtuar në pajtim me nenin 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13.

Për këto arsye i Padituri/Apeluesi nuk ka vepruar sipas ligjit dhe nuk ka përmbushur obligimet e tij gjatë shqyrtimit dhe rregullimit të ankesave të NSH "██████████". Kolegji i Ankesave konsideron se lista është përfundimtare vetëm atëherë kur të jetë shqyrtuar në mënyrën e duhur. Si pasojë e kësaj duhet të publikohet edhe lista e re e shqyrtuar dhe e korrigjuar sipas nenit 10.3 të RREG UNMIK-ut 2003/13.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it (nënshkrimi)

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it (nënshkrimi)

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it (nënshkrimi)

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it (nënshkrimi)